

COVID - 19 STRATEGJIA E RIHAPJES



TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|--------------------|--|----|
| Kapitulli 1 | Situata aktuale në Shqipëri | 04 |
| | 1.1 Informacion epidemiologjik për situatën aktuale | 04 |
| | 1.2 Masat e marra, përfitimet dhe kostot | 08 |
| Kapitulli 2 | Strategjia e rihapjes | 10 |
| | 2.1 Kriteret për vlerësimin e situatës | 10 |
| | 2.2 Parimet bazë | 11 |
| | 2.3 Paketa e masave shoqëruese | 14 |
| | 2.4 Katër fazat e lehtësimit | 16 |
| Kapitulli 3 | Sistemi shëndetësor | 20 |
| | 3.1 Fuqizimi i sistemit shëndetësor si rezultat i Planit të Veprimit kundër COVID-19 | 20 |
| | 3.2 Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore | 22 |
| | 3.3 Plani i masave të ofrimit të shërbimit shëndetësor | 22 |
| | 3.3.1 Shërbimi Parësor | 23 |
| | 3.3.2 Shërbimi Spitalor | 23 |
| | 3.4 Fazat e sistemit shëndetësor | 23 |
| | 3.5 Masat e komunikimit për ofrimin e kujdesit shëndetësor | 25 |
| Kapitulli 4 | Vlerësimi i riskut dhe rekomandimet për lehtësimin e masave për biznesin | 26 |
| | 4.1 Përcaktimi i kategorive të riskut | 26 |
| | 4.2 Protokollet sipas nivelit të riskut | 28 |
| Kapitulli 5 | Monitorimi i situatës | 29 |
| | 5.1 Monitorimi intensiv i situatës epidemiologjike dhe mekanizmat e frenimit të fazave të rihapjes | 29 |
| Kapitulli 6 | Konkluzione | 32 |
| Kapitulli 7 | Referenca | 34 |
| Aneksi I | Veprimet e ndërmarra në strategjinë e kufizimit të përhapjes së COVID-19 | 36 |
| Aneksi II | Protokollet e masave sipas nivelit të riskut | 40 |

KAPITULLI 1

Situata aktuale në Shqipëri


Pandemia e shkaktuar nga SARS-CoV-2 përbën një sfidë globale jo vetëm për faktin se është një virus i ri dhe i panjohur, por edhe për nga natyra e tij dhe fakti se shkakton sëmundje të rëndë tek njerëzit dhe përhapet potencialisht lehtësisht edhe ndërmjet personave që nuk shfaqin simptoma. Rritja e shpejtë e numrit të të infektuarve dhe të atyre që shfaqin forma të rënda të sëmundjes COVID-19 e për pasojë edhe rritja e numrit të të vdekurve, ka detyruar qeveritë në të gjithë botën të marrin masa që variojnë nga rritja e kapaciteteve spitalore e deri tek vendimet drastike që limitojnë aktivitetet e që kanë për qëllim ngadalësimin e shpërhapjes së virusit.

Në këto kushte dhe duke njohur natyrën e koronavirusit të ri, ndalimi i plotë i përhapjes së tij është virtualisht i paarrtshëm. Për këtë arsye, qëllimi është rrafshimi i kurbës së epidemisë, e cila në mungesë të këtyre masave shtrënguese do të kishte një pjerrtësi të madhe, që do të përkthehej në një shkallë të lartë infektimi e, për pasojë, mbingarkim të sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe rritje të fataliteteve. Në ballë të kësaj sfide botërore duket se prioritet është bërë ruajtja e jetëve dhe shëndetit të popullatës dhe kanë kaluar në plan të dytë interesat ekonomikë. Megjithatë, vlen të theksohet se të dyja këto janë të ndërthurura dhe të pandashme nga njëra tjetra duke qënë se zhvillimi ekonomik është i pamundur nëse virusi ka përhapje të gjërë në popullsi. Në të njëjtën linjë, efektet e dëmshme të masave shtrënguese përkthehen në vështirësi ekonomike, sociale, psikologjike, etj. Për këtë arsye, qëllimi i kësaj strategjie është identifikimi i mënyrave për daljen nga kriza, duke kombinuar optimizimin e luftës kundër pandemisë me fleksibilitetin e masave shtrënguese në raport me riskun dhe duke krijuar një strategji të qëndrueshme ndër kohë.

1.1 Informacion epidemiologjik për situatën aktuale

E gjithë përballja me epideminë e COVID-19 apo SARS-CoV-2 deri tani në Shqipëri është kryer duke u mbështetur dhe bazuar me përpikmëri në planin e parapërgatitjes ndaj pandemisë "Plani i Veprimit COVID-19" i MSHMS, i cili ka patur për qëllim orientimin e veprimeve dhe masave të marra sipas skenarëve të hartuar në bazë të modeleve epidemiologjike. Falë masave të marra në kohë nga Qeveria shqiptare dhe parashikimit e ndjekjes rigoroze të skenarëve të planit parapërgatitor, situata aktuale paraqitet me një tablo të butë të epidemisë si dhe me një përballje të mirë të sistemit shëndetësor kundrejt rasteve të COVID-19.


Mbështetur në të dhënat e epidemisë apo pandemisë COVID-19 në vend, është kryer dhe vlerësimi javor dhe është përcaktuar trajektorja e numrit efektiv riprodhues (grafiku i mëposhtëm).



Grafiku 1 Vlerësimi javor i numrave riprodhues


Siç vihet re është e dukshme se gjatë javës së parë, 8 – 14 Mars, $R(t)$ ishte e lartë dhe epidemia po përhapej me shpejtësi, në javën e dytë, 15 – 21 mars, $R(t)$ ajo nisi të bjerë dhe me tej përhapja e sëmundjes nisi të bjerë, në javën e tretë, nga 22 – 28 mars, $R(t)$ luhatej lart e poshtë drejt njëshit dhe sëmundja hyri në fazën e vetë-përmbajtjes. Në mënyrë përmbljedhëse, trajektorja e kurbës së numrit efektiv riprodhues është qartësisht në rënie dhe kjo sugjeron se masat e kontrollit po ndikojnë pozitivisht në zvogëlimin progresiv të transmetimit të COVID-19 në Shqipëri.

Gjithashtu, të dhënat e deritanishme tregojnë për një ulje të shpeshtësisë së infeksionit në thuajse shumicën e qyteteve të vendit dhe po ashtu, vihet re një ulje e hospitalizimeve për shkak të COVID-19 (sikundër tregohet edhe nga grafiku mëposhtëm) dhe të rasteve që kanë nevojë për kujdes të terapisë intensive.



Grafiku 2 Manaxhimi i të sëmurëve me COVID-19 në Shqipëri deri në datën 17 Prill 2020 (MSHMS, OBSH)

Vlen të theksohet se, kemi arritur në fazën kur numri i personave të shëruar ka tejkaluar numrin e rasteve aktive me COVID-19, sikundër ilustron edhe nga grafiku i mëposhtëm.



Grafiku 3 Ecuria e personave të shëruar, rasteve aktive dhe vdekjeve deri me 17 Prill 2020 (MSHMS, OBSH)

Gjithsesi, kemi patur dhe humbje jete për vetë faktin se duke qënë një virus i ri me të panjohura dhe me aftësi përhapje të shpejtë nga një person në tjetrin ka shkaktuar sëmundje me klinikë të rënduar (COVID-19) sidomos në pacientët me sëmundje bashkshoqëruese. Gjatë vlerësimit të deritanishëm të epidemisë SARS-CoV-2 totali i testeve të rasteve pozitive për COVID-19 (d.m.th rastet me klinikë akute) është rritur në mënyrë progresive nga evidentimi i rastit të parë në vend më 9 Mars 2020 e në vijim. Kjo, duke u mbështetur në strategjinë dhe rekomandimet e OBSH mbi testimin e të gjithë rasteve të dyshuar për COVID-19, mbështetur në përkufizimin e rastit dhe një gjurmimi të thelluar deri në 80% të kontakteve të rasteve positive. Gjithsesi, sipas të gjitha gjasave mund të kemi një përqindje më të lartë të pozitivitetit kundrejt rasteve të pa identifikuar në popullatë që mund të jenë mbartës, pa paraqitur asnjë shenjë klinike.

Mbështetur në të dhënat epidemiologjike, në nivelin e agresivitetit klinik të rasteve të hospitalizuara dhe në terapi intensive, të rasteve të moderuara apo të rasteve të lehta që kanë kërkuar vetëizolim, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndërmarrë në kohë një sërë masash mbështetur në planin e parapërgatitjes ndaj pandemisë të SARS-CoV-2, dhe për rrjedhojë sistemi shëndetësor është përballur deri tani me një situatë të qëndrueshme ku është konstatuar një përbalim në kohë i fluksit të rasteve COVID-19 duke ofruar shërbim për çdo pacient dhe kapacitete optimale në shtretër dhe akses në terapi intensive e respiratorë.


Në situatën aktuale, në fokusin tonë janë, strategjia e vijimësisë së testimit, forcimi i mëtejshëm i survejancës dhe gjurmimit të kontakteve, masave mbrojtëse personale (përfshirë distancimin fizik), forcimi i sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe informimi i publikut. Promovimi i shëndetit mendor në grupet vulnerabël që jetojnë nën masa distancimi fizik gjithashtu ka rëndësi për të siguruar rezistencën e për të garantuar zbatimin e mëtejshëm të këtyre masave.

Masat e rrepta të distancimit fizik janë zbatuar në mënyrë sistematike, por është e rëndësishme të përcaktohet një qasje e shëndoshë për lehtësimin apo zbutjen e tyre në mënyrë graduale.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, kjo strategji do të ndikojë dhe në rishikimin e të gjitha masave, të marra nën efektin e pandemisë, për të orientuar ndjekjen e hapave për kujdesin shëndetësor dhe për sëmundshmërinë përveç SARS-CoV-2, impaktin socio-psikologjik si dhe impaktin ekonomik. Prandaj, plani ynë për lehtësimin e masave bazuar në rekomandimet e Qendrës Europiane të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në eksperiencën e vendeve të përballura më parë në kohë, do të sigurojë që kapacitetet dhe masat e duhura mbrojtëse të ulin riskun e një mbingarkese nga mundësia e përsëritjes së infeksionit apo rritja e transmetimit në grupet vulnerabël të popullatës dhe në popullatën e gjerë.

1.2 Masat e marra, përfitimet dhe kostot

Sikundër u theksua dhe më sipër, masat e marra nga Shqipëria, që në javën e parë të Marsit 2020, kanë për synim sheshimin e kurbës dhe zvogëlimin e barrës mbi sistemet e kujdesit shëndetësor nëpërmjet distancimit social, që në vetvete synon zvogëlimin e përhapjes së virusit ndërmjet individëve. Në pamundësi për të ndaluar plotësisht pandeminë, kjo strategji fiton kohë, gjatë së cilës merret/grumbullohet më shumë informacion rreth virusit, përhapjes së tij dhe sëmundjes që shkakton, si edhe forcohen kapacitetet dhe zhvillohen strategji për në vazhdimësi.



Grafiku 4 Sheshimi i kurbës nëpërmjet masave kufizuese

Në fazën që ndodhemi aktualisht, megjithëse është e vështirë të themi me siguri se cilat masa kanë ndikuar në cilat mënyra, në një vështrim të përgjithshëm duket se paketa e masave shtrënguese ka shërbyer më së miri për të mbajtur situatën nën kontroll. Mbështetja e epidemisë apo e pandemisë me masat e distancimit fizik, karantinës, masat e higjenes respiratore dhe personale kanë pasur synimin e vetëm të rrafshojnë kurbën epidemike të COVID-19. Efekti i zbatimit të të gjithë masave në Shqipëri, dhe pse jemi ende herët në këtë epidemi, kanë treguar më së miri efektin e tyre pozitiv në zvogëlimin e zinxhirit të transmetimit, për të mos patur një incidencë të lartë të sëmundjes (sidomos në grupet me të riskuara), për të mos mbingarkuar sistemin shëndetësor si dhe për të mënjeluar vdekjet.

Megjithëkëtë, kontrolli i përhapjes së SARS-CoV-2 është shoqëruar me kosto të mëdha ekonomike dhe jo vetëm.

Krahas kostove ekonomike, një aspekt tjetër i rëndësishëm është ai i kostove mjekësore. Masat shtrënguese kanë kufizuar ndjeshëm ndihmën mjekësore që i ofrohet pacientëve të tjerë. Me mbylljen e shumë klinikave, shtyrjen e ekzaminimeve apo ndërhyrjeve të planifikuara, anulimin e konsultave mjekësore, etj., ndihma mjekësore që i ofrohet qytetarëve është tepër e limituar. Megjithëse aktualisht është e pamundur të kuantifikohet kosto oportune e këtyre masave shtrënguese përsa i përket kujdesit shëndetësor, mund të themi me siguri që me zgjatjen e periudhës së aplikimit do të rritet edhe dëmi i shkaktuar që mund të rezultojë edhe në rritje të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë, sidomos në grupet më vulnerabël si personat me sëmundje kronike, të moshuarit, të varfërit, etj. Fokusimi i forcave dhe burimeve në trajtimin e pacientëve me COVID-19 do të përkthejë në ulje të aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët e tjerë.

Nga ana tjetër, distancimi social shoqërohet edhe me kosto sociale dhe psikologjike, veçanërisht nëse flasim për periudha aplikimi që zgjasin në kohë. Pavarësisht se fillimisht masat shtrënguese u panë me pozitivitet dhe pati mirëkuptim të gjërë, izolimi dhe kufizimet e zbatuara në periudha të zgjatura kanë pasojë psikologjike dhe sociale. Kjo është veçanërisht e vërtetë për personat që jetojnë vetëm, familjet me fëmijë, ata që jetojnë në kushte të vështira, të sëmurët, etj. Për më tepër, kostot ekonomike përkthehen drejtpërdrejtë në kosto psikologjike dhe sociale duke qënë se një pjesë e mirë e popullatës ndjehen të pasigurtë në lidhje me të ardhmen dhe qëndrueshmërinë e tyre ekonomike. Kjo si pasojë, sjell një rritje të konflikteve brenda familjes, por jo vetëm.

Të gjitha këto problematika të ngritura më sipër, shoqëruar me kostot e pamohueshme ekonomike të shkaktuara si pasojë e mbylljes apo kufizimit të veprimtarisë së bizneseve, na ballafaqojnë me një nevojë të madhe dhe urgjente për hartimin e strategjive që vendosin një balancë midis kontrollit të situatës në lidhje me parandalimin e përhapjes së SARS-CoV-2 dhe optimizimin e masave për të minimizuar kostot oportune.

KAPITULLI 2

Strategjia e rihapjes

2.1 Kriteret për vlerësimin e situatës

Masat e distancimit social të ndërmarra deri më sot kanë dhënë rezultatet e tyre për të mos patur një incidencë të lartë të sëmundjes, sidomos në grupet më të riskuara, për të mos mbingarkuar sistemin shëndetësor si dhe për të mënjeluar vdekjet. Sikundër u përmend dhe më lartë, lehtësimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë graduale duke u mbështetur në disa kritere të listuara më poshtë që ndihmojnë në përcaktimin e kohës së përshtatshme për lirimin e masave shtrënguese.

Së pari duhet vlerësuar gatishmëria përsa i përket kriterit epidemiologjik i cili tregon se përhapja e virusit ka pësuar rënie të konsiderueshme dhe të qëndrueshme për periudha të gjata kohore. Kjo, duke u bazuar në tregues të tillë si rënia e qëndrueshme e numrit të rasteve të reja, shtrimeve dhe pacientëve nën kujdes intensiv.

Krahas kriterit epidemiologjik duhet vlerësuar edhe kapaciteti i sistemit shëndetësor veçanërisht shkalla e mbushjes/zënies për njësitë e kujdesit intensiv, sigurimi i numrit të përshtatshëm të shtretërve, aksesueshmëria e barnave të nevojshëm për trajtimin e të sëmurëve veçanërisht në kujdesin intensiv, sigurimi i vazhdimësisë të furnizimit me mjete mbrojtëse personale, etj. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar gjithashtu edhe rikuperimit dhe rikthimit në funksionim normal të sistemit të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e tij, duke u fokusuar veçanërisht në aksesueshmërinë e tyre prej personave që bëjnë pjesë në grupet më vulnerabël.

Së fundi, është e rëndësishme që të garantohen dhe alokohen kapacitetet dhe burimet e nevojshme për monitorimin e situatës pas lirimit të masave shtrënguese, duke përfshirë shtimin e testimeve të kryera për të monitoruar përhapjen e virusit, kombinuar me gjurmimin e kontakteve dhe duke vlerësuar mundësinë për të izoluar individët në rast të rishfaqjes dhe transmetimit të mëtejshëm të infeksionit. Krahas kësaj duhet të shqyrtohet mundësia për hartimin dhe implementimin e protokolleve të testimeve serologjike për të hetuar imunitetin në popullatë duke zbuluar kështu momentin kur mund të thuhet se popullata në masë të gjerë e ka mposhtur sëmundjen dhe ka fituar imunitet.

Krahas kritereve të mësipërme, lehtësimi i masave shtrënguese do të bazohet edhe në plotësimin e parametrave të mëposhtëm të rekomanduar nga OBSH, që ndihmojnë në përcaktimin e gatishmërisë për rikthimin në normalitet.

- Transmetimi i infeksionit është nën kontroll.
- Sistemi shëndetësor është i aftë të identifikojnë, testojnë, izolojnë dhe të trajtojnë çdo rast e të gjurmojnë të gjitha kontaktet.
- Risku është i minimizuar sidomos në pikat më vulnerabël, siç janë për shembull shtëpitë për të moshuarit.
- Sistemi arsimor, bizneset dhe institucionet e tjera kanë përcaktuar dhe janë në gjendje të zbatojnë masat parandaluese.
- Risku i importimit të rasteve të reja është i menaxhueshëm.
- Komuniteti është informuar dhe i angazhuar në përmbushjen e rregullave të nevojshme për lehtësimin e masave shtrënguese.

Të dhënat e deritanishme tregojnë për një ulje të shpeshtësisë të infeksionit në thuajse shumicën e qyteteve të vendit. Po ashtu, vihet re një ulje e shtrimeve në spital për shkak të COVID-19 dhe të rasteve që kanë nevojë për kujdes intensiv. Deri më tani janë dokumentuar të gjitha rastet e dyshuara dhe kontaktet e tyre, për të cilat është kryer testimi. Në vendin tonë, masat e kontrollit kanë rezultuar efektive në minimizimin e riskut për të moshuarit në institucionet rezidenciale.

Procesi i gjurmimit të kontakteve është kryer me rreptësi dhe do të përforcohet edhe më tej nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të shëndetit publik dhe inteligjencës epidemike. Kjo strategji, ashtu sikurse edhe plani i veprimit për përgatitjen ndaj COVID-19, është i një natyre dinamike, çka do të thotë se do të rishikohet vazhdimisht dhe ndryshimet do të pasqyrojnë zhvillimet më aktuale të situatës.

2.2 Parimet bazë

Sikundër u përmend edhe në kapitullin e mësipërm, zhvillimi i mëtejshëm i masave në përputhje me situatën duhet të jetë i mirë menduar dhe i zbatuar me kujdes. Nëse masat e marra deri më tani do të hiqeshin plotësisht dhe në mënyrë të menjëhershme, virusi do të përhapej shpejt dhe gjërësisht midis asaj pjese të popullatës që nuk ka fituar imunitet. Nga ana tjetër, mbajtja në fuqi e këtyre masave pa i rishikuar për t'ja përshtatur situatës aktuale do të kishte pasoja negative dhe zbatimi i tyre afatgjatë do të ishte i pamundur.

Për këtë arsye, sikundër është përmendur edhe më sipër, në të ardhmen masat duhet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë ofrimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor, por edhe të kenë qëndrueshmëri dhe të jenë të zbatueshme për periudha të gjata kohore. Për këtë arsye është e nevojshme që të kryhet një kalim gradual drejt një strategjie të

bazuar në nivelin e riskut duke kombinuar lehtësimin e masave me efekt/ndikim në sferën sociale dhe ekonomike me mbrojtjen e vazhdueshme dhe efektive ndaj përhapjes së virusit. Planifikimet e nevojshme për këtë kalim gradual duhet të fillojnë menjëherë në të gjitha nivelet.


Çdo vendim për të hapur, për të shtyrë hapjen apo për të ri-mbyllur një institucion, biznes, etj., duhet të bëhet duke shqyrtuar situatën aktuale. Manaxhimi i fazës së lehtësimit duhet të lidhet ngushtë me monitorimin e zhvillimit të pandemisë dhe politikave dhe masave të marra për ta kontrolluar atë.

Të gjitha vendimet e marra për lehtësimin e masave shtrënguese duhen marrë duke patur parasysh parimet e mëposhtme:

- Vendimet duhet të bazohen në analiza shkencore dhe duhet të kenë përherë si emërues shëndetin publik. Vendimi për përshkallëzimin e masave shtrënguese apo heqjen totale të tyre është një proces politikëbërje shumëdimensional që përfshin ekuilibrimin e perfitimeve të arritura në shëndet publik me efektet e tjera ekonomike dhe sociale. Megjithatë parësore për vendin tonë mbetet ruajtja e shëndetit publik dhe të gjitha vendimet dhe masat do të merren duke patur këtë parasysh si edhe duke u bazuar në të dhenat më të fundit shkencore.
- Për të garantuar mbarëvajtjen e lehtësimit të masave është e rëndësishme të ketë komunikim, bashkërendim dhe bashkëpunim midis aktorëve të ndryshëm dhe midis pushtetit qendror dhe atij vendor. Të gjendur përballë një pandemie me plot të panjohura dhe pak përvoja të ngjashme, rikthimi në normalitet do të jetë një proces i vështirë dhe që do të marrë kohë dhe ekuilibrat e vendosur do të jenë të brishtë. Për të siguruar që lehtësimi i masave të mos ketë efektin e kundërt është thelbësor kontributi i të gjithë strukturave.
- Së fundi, në ballë të një pandemie me përmasa globale është i rëndësishëm të sigurohet bashkëpunimi dhe solidariteti i ndërsjelltë me vendet fqinje. Gjatë gjithë procesit, por veçanërisht në fazat e ardhshme kur mund të diskutohet për një rihapje të kufijve, bashkërendimi dhe bashkëpunimi është thelbësor për të garantuar të mirën e përbashkët. Në të njëjtën mënyrë, duke qenë se çdo vend ka patur veçoritë e veta, ndarja e konkluzioneve dhe mësimave të nxjerra është i një rëndësie të veçantë.

Në lirimin e masave në përputhje me vlerësimin e riskut ka vend për diferencime, siç janë diferencimet ekonomike, diferencimet rajonale dhe diferencimet sociale. Në këtë aspekt, edhe pse në parim kriteret e njëtrajtshme e lehtësojnë procedurën, dallime të forta rajonale mund të shfaqen gjatë rrjedhës së pandemisë. Ky parim shprehet qartë edhe nga grafiku i mëposhtëm që dëshmon se qytete të ndryshme brenda Republikës së Shqipërisë kanë patur incidencë të ndryshme të të infektuarve. Diferenca të tilla aktualisht mund të shihen në vatrat e infeksionit, në numrin e individëve të infektuar apo në numrin e pacientëve të shtruar në spital. Masat duhet të përshtaten në përputhje me ndryshime

të tilla rajonale. Duke patur parasysh këtë, rajonet me shkallë të ulët infeksioni dhe risk më të ulët të infeksionit dhe me më pak mundësi/gjasa për përhapje mund të kenë përparësi në lehtësimin e masave. Po kështu, nëse gjatë survejimit zbulohet se zona apo rajone të caktuara shfaqin një nivel të lartë imuniteti të fituar, atëherë mund të tregohet përparësi në lehtësimin e masave.



Grafiku 5 Raste me COVID-19 për 100'000 banorë sipas qyteteve deri me 17 Prill 2020 (MSHMS, OBSH)

Në situatën aktuale është e rëndësishme që objektivat të jenë në qendër të vendimmarrjes politike në përputhje me përgjegjësinë për ruajtjen e shëndetit të shoqërisë.

Objektivat do të shoqërohen me disa nga veprimet e mëposhtme:

- Parandalimi i ripërhapjes së virusit e shoqëruar me rritjen e imuniteti natyror të popullatës.
- Fuqizimi i sistemit shëndetësor për të siguruar në kohë trajtimin e duhur për një numër pacientësh që do të shfaqin shenjat e prekjes nga COVID-19 apo dhe sëmundje të tjera bashkëshoqëruese.
- Mbrojtjen e grupeve me risk të lartë.
- Shmangien dhe uljen e vështirësive sociale dhe psikologjike për ata që e kanë të nevojshme.
- Vazhdimin e aktiviteteve ekonomike duke u ruajtur nga rreziku shëndetësor.
- Kufizimin e shkeljeve mbi të drejtat themelore të individit në atë që është e nevojshme dhe proporcionale.

Një ndër objektivat e tjerë të rëndësishëm që duhet të arrihen me zbatimin e veprimeve strategjike është mbrojtja e grupeve vulnerabël nga COVID-19, siç janë të moshuarit, personat me patologji kronike dhe personat me aftësi të kufizuara.

Materiale të mjaftueshme të mbrojtjes personale janë të nevojshme për kujdesin e tyre

gjatë pandemisë dhe në mënyrë të veçantë më pas. Për të mbrojtur qytetarët e moshuar, Qeveria ka ndaluar vizitat në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit pa familje, duke pasur shërbim 24 orë brenda mjediseve rezidenciale, duke zbatuar masat e higjienës dhe vetëkarantinimit e punonjësve të këtyre shërbimeve brenda institucioneve ku ata punojnë. Qeveria gjithashtu ka lëshuar rekomandime të rrepta për njerëzit e moshës mbi 70 vjeç për të shmangur kontaktin me të tjerët, dhe që e gjithë popullata të kufizohet në vizitat tek njerëzit e moshuar. Për këto grupe vulnerabël lehtësimi i masave do të fillojë më vonë se për pjesën tjetër të popullatës.

2.3 Paketa e masave shoqëruese

Për sa më sipër, bazuar në njohuritë e deritanishme rekomandohet që ri-hapja e shoqërisë:

A. Të jetë graduale:

- Duhet të ketë një kohë të mjaftueshme, prej minimumi 2 javësh, nga një hap në tjetrin për të lejuar monitorimin e efekteve të mundshme negative lidhur me rifillimin e qarkullimit të SARS-Cov-2.
- Fillimisht të rihapen aktivitetet me më shumë efekt në ekonomi dhe më pak efekt në trasmetimin e infeksionit (risk të lartë aktivitete me grumbullim më të madh të njerëzve që vijnë nga distanca të largëta).

B. Të shoqërohet me disa kufizime lidhur me lëvizjen dhe kontaktet e njerëzve për të paktën 2 muaj nga momenti i fillimit gradual të hapjes:

- Aktivitetet sportive dhe artistike me grumbullime mbi 10 vetë duhet të vijojnë të ndalohen.
- Të moshuarit dhe personat me semundje kronike do të duhet të vijojnë kufizimin e lëvizjeve midis qyteteve dhe minimizimin e aktiviteteve të tjera sociale.
- Përparësi në lëvizjen ndër rajonale i duhet dhënë personave me risk të ulët.
- Personat që vijnë nga vende me risk të lartë (raportojnë ende raste ditore brenda 2 javësh ose/dhe kanë mbi 15 vdekje/1 milion) duhet të vijojnë të karantimohen. Ky parim duhet pasur parasysh në muajt e verës me mundësinë e rifillimit të turizmit.
- Puna në distancë duhet të vijojë të nxitet sa herë që është e mundur.
- Duhet të përgatiten rregullore të veçanta për shërbimet tregtare dhe transportin publik.

C. Të shoqërohet me rekomandime të forta për publikun, punonjësit dhe nxënësit lidhur me minimizimin e trasmetimit:

- Rekomandimi i mbajtjes së maskave për të gjitha rastet kur aktiviteti nënkupton kontakte njerëzore;

- Rekomandimet lidhur me ruajtjen e distancës fizike deri në 2 m të bëhen të mundura;
- Rekomandimet mbi larjen e duarve dhe dezinfektimin, etj.

D. Të kryhet lehtësimi i masave duke siguruar njëkohësisht kapacitete të mjaftueshme për monitorimin shëndetësor dhe përballim të rikthimit të epidemisë:

- Kapacitete epidemiologjike për të gjurmuar të gjitha rastet e dyshuara apo më tej;
- Kapacitete laboratorike për të testuar dhe diagnostikuar të gjitha rastet e dyshuara apo më tej;
- Kapacitete laboratorike në teste të shpejta të sigurta dhe teste serologjike për të vlerësuar mbrojtjen imunitare;
- Përforsim i sistemit tëurvejancës dhe njoftimit të hershëm në sistemin shëndetësor për identifikimin e çdo rasti të dyshuar dhe sidomos atyre që duhet të shtrohen në spital;
- Kapacitete spitalore të dedikuara me shtretër për kujdes akut dhe kujdes intensiv;
- Stok të mjaftueshëm me mjete të mbrojtjes personale për të përballuar të paktën një periudhë prej 2 javësh qarkullim intensiv të virusit (20-100 raste të reja në ditë).

E. Të shoqërohet me thellim të masave për izolim/karantinë të personave të konfirmuar dhe të kontakteve:

- Kudo ku është e mundur dhe sidomos në rastet kur rrezikohen persona të moshuar apo me risk të lartë, izolimi dhe karantina të realizohen në kushte të centralizuara, pra në një mjedis të dedikuar. Kjo do të ulte në minimum riskun për infektim në familje etj.

F. Hapat ndërmerren duke observuar të paktën 14 ditë rënie të qëndrueshme ose nivel shumë të ulët të riskut për:

- Rastet ditore të diagnostikuara;
- Rastet e shtruara në spital;
- Rastet në kujdes intensiv.

Kontrolli i zbatimit të masave të koordinohet midis strukturave të Inspektoriatit Shtetëror duke përfshirë këtu dhe atë Sanitar dhe të Policisë së Shtetit.

Vlerësimi i stuatës epidemiologjike në lidhje me gjurmimin e rasteve me COVID-19, në rastet kur gjatë fazave të lehtësimit do të kemi ndryshime të trendit, shoqëruar kjo me rritje të numrit të rasteve, të shtrimeve në spital apo dhe në kujdesin intensiv, do të shoqërohet menjëherë më rishikimin e masave sipas fazave të caktuara dhe në rikthim të menjëhershëm në zbatimin e masave strikte të distancimit social.

2.4 Katër fazat e lehtësimit

Duke u bazuar në rekomandimet e OBSH si edhe vlerësimin e riskut brenda vendit, kthimi në normalitet duhet të kryhet në mënyrë graduale dhe do të përfshijë disa faza të shtrira në kohë.

Faza 1:

Kjo fazë kërkon një gjurmim sa më agresiv të kontakteve dhe monitorim strikt të efikasitetit të masave të izolimit dhe karantinës. Po ashtu, kërkon edhe monitorimin ditor të shpeshtësisë të infeksionit, kapacitetit të shtretërve në spitale, urgjencës mjekësore, kontaktet e gjurmuara për çdo person dhe përqindjes së pozitivitetit të mostrave. Pra kjo fazë kërkon thellimin e hetimit epidemiologjik duke parë dhe mundësinë e përdorimit të testeve të shpejta (të validuara nga OBSH) sa më afër qytetarit, përmirësim të infrastrukturës të shërbimit të inteligjencës epidemike dhe rritje të mjeteve të mbrojtjes personale për punonjësit e shërbimeve shëndetësore dhe atyre sociale. Po ashtu, të vlerësohen të gjitha testet diagnostike që tregojnë se personat mund të kenë kaluar sëmundjen, duke lejuar edhe matjen e përqindjes së personave asimptomatikë dhe rolit që ata luajnë në përhapjen e sëmundjes.

ISHP do të përgatisë studimin e qarkullimit të virusit në popullatë dhe të fillojë zbatimin e tij. ISHP gjithashtu të ndertojë edhe një plan të përcaktimit të matjes së imunitetit të popullatës ndaj koronavirusit, kur testet përkatëse të jenë të gatshme. Gjithashtu kërkohet edhe hartimi i protokolleve të qarta të kujdesit shëndetësor dhe kryerja e vlerësimeve paraprake të këtij kujdesi dhe medikamenteve të përdorura, për të parë efikasitetin e tyre.

Shërbimet shëndetësore online apo me telefon për COVID-19 do të vazhdojnë, ndërkohë që fillon edhe normalizimi i shërbimeve të tjera shëndetësore. Vlen për t'u theksuar parimi mbi rajonalizimin: masat mund të përshkallëzohen në bazë të nivelit të riskut sipas rajoneve.

Faza 2:

Në këtë fazë zbatohen të njëjtat masa në lidhje me gjurmimin e kontakteve, testimin dhe përmirësimin të infrastrukturës dhe monitorimit, si dhe të efektivitetit të izolimit dhe karantinës por kemi masa më lehtësuese. Nëse na lejon infrastruktura si dhe hedhja në treg e testeve përkatëse, të realizohet matja e nivelit të mbrojtjes së popullatës. Gjithashtu do të mblidhen të dhëna edhe mbi terapitë përkatëse dhe efiakasitetin e tyre. Vlen parimi mbi rajonalizimin: masat mund të përshkallëzohen në bazë të nivelit të riskut sipas rajoneve.

Faza 3:

Në këtë fazë zbatohet matja e imunitetit të popullatës për të patur shifra të qarta mbi numrin e personave që mund të kenë kaluar sëmundjen. Vazhdojnë të kryhen testime, gjurmimi i kontakteve dhe monitorimi i sistemit, por zbatohen vetëm masat vetjake të distancimit fizik. Në këtë fazë kemi medikamente të efektshme dhe ka të dhëna të qarta për ulje të shpeshtësisë së infeksionit.

Faza 4:

Kthimi i plotë në normalitet do të ndodhë kur të kemi një nivel imuniteti të lartë ndaj sëmundjes, qoftë dhe me ndihmën e një vaksine, si dhe kur shpeshtësia e sëmundjes nuk përbën më problem madhor të shëndetit publik.

Tabela 1 Katër fazat e rihapjes

| | Individë | Të punësuar | Institucione/Biznese |
|---------------|--|--|--|
| Faza 1 | <p>Ndalesë e përqaftimeve dhe shtrëngimit të duarve; Rekomandohet përdorimi i maskave</p> <p>Ruajtja e distancës 2 m në të gjitha aktivitetet;</p> <p>Ndalesë e grumbullimeve të më shumë se 10 personave në mjedise të caktuara, sidomos të mbyllura dhe ku duhet të ruhet distanca 2 m.</p> <p>Kufizimi i lëvizjeve vetëm për arsye thelbësore.</p> <p>Personat me moshë mbi 70 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese do të vazhdojnë të ndjekin rregullat e mëparshme të karantinës, pra qëndrimin në shtëpi.</p> | <p>Çdo biznes apo institucion shtetëror apo jo, të promovojë punën nga shtëpia kur kjo mund të kryhet dhe ta alternojë atë.</p> <p>Mjetet e transportit publik duhet të evitohen në këtë fazë.</p> <p>Do të lejohen taksitë brenda qytetit dhe në një moment të dytë do të gjykohet për taksitë ndër qytetase.</p> <p>Ndalimi i vizitave në spitale apo institucionet e kujdesit social duhet të vazhdojë.</p> | <p>Masat e higjenes në mjediset publike/private: pastrimi dhe dezinfetimi i cdo mjedisi publik/privat, shkallëve të pallateve, institucioneve.</p> <p>Ndërkohë në këtë fazë ndalohen grumbullimet dhe vazhdojnë të qëndrojnë të mbyllura aktivitetet kulturore dhe sportive.</p> <p>Restorantet dhe kafenetë vazhdojnë të japin shërbimin "merr dhe ik" si dhe në shtëpi dhe nuk janë të hapura.</p> <p>Dyqanet ushqimore apo dyqanet e specializuara me pakicë, bankat etj., duhet të respektojnë rregullat e mësipërme të distancimit fizik.</p> |

| | Individë | Të punësuar | Institucione/Biznese |
|---------------|---|---|--|
| | <p>Të promovohet vetëkarantina për 14 ditë dhe vetëkontrolli duke matur temperaturën dy herë në ditë sipas rekomadimeve përkatëse.</p> | | <p>Çdo biznes duhet të ndërtojë planin e tij të mbrojtjes ndaj COVID-19 dhe masave të distancimit fizik. Gjithashtu, bizneset e ndërtimit dhe prodhimit të vijojnë duke patur planin e masave të distancimit fizik.</p> <p>Ne supermarket dhe në dyqane rekomandohet të përdoren nga qytetarët maska dhe mund të përdoren maska tekstili, të cilat duhet të përdoren sipas rregullave të caktuara.</p> <p>Shkollat të vazhdojnë të qëndrojnë të mbyllura.</p> |
| Faza 2 | <p>Ndalesë e përqaftimeve dhe shtrëngimit të duarve; Rekomandohet përdorimi i maskave</p> <p>Ruajtja e distancës 2 m në të gjitha aktivitetet;</p> <p>Ndalesë e grumbullimeve të më shumë se 50 personave në mjedise të caktuara, sidomos të mbyllura dhe ku duhet të ruhet distanca 2 m.</p> <p>Lehtësimi i lëvizjeve jo vetëm për arsye thelbësore.</p> <p>Personat me moshë mbi 70 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese do të</p> | <p>Çdo biznes apo institucion shtetëror apo jo, të promovojë punën nga shtëpia kur kjo mund të kryhet dhe ta alternojë atë.</p> <p>Mjetet e transportit publik fillojnë të funksionojnë me kufizime dhe transporti ndërqytetas lejohet gradualisht</p> <p>Do të lejohen taksitë brenda qytetit dhe ndër qytetase.</p> | <p>Masat e higjenes në mjediset publike/private: pastrimi dhe dezinfetimi i cdo mjedisi publik/privat, shkallëve të pallateve, institucioneve.</p> <p>Rihapja e bizneseve duke ruajtur masat e distancimit fizik dhe për ato që nuk kanë mundësi të vazhdojnë më shërbimin online apo "merr dhe ik". Çdo biznes duhet të ndërtojë planin e tij të mbrojtjes ndaj COVID-19 dhe masave të distancimit fizik.</p> <p>Zbatim i planit të masave në të gjitha bizneset.</p> <p>Zbatim i planit të masave në të gjitha bashkitë.</p> |

| | Individë | Të punësuar | Institucione/Biznese |
|---------------|--|--|---|
| | <p>lejohe lëvizja vetëm për arsye thelbësore</p> <p>Të promovohet vetëkontrolli duke matur temperaturën dy herë në ditë sipas rekomadimeve përkatëse</p> | | <p>Ne supermarket dhe në dyqane rekomandohet të përdoren nga qytetarët maska dhe mund të përdoren maska tekstili, të cilat duhet të përdoren sipas rregullave të caktuara.</p> <p>Në këtë fazë hapen dyqanet dhe shërbimet e qendrave tregëtare duke respektuar masat dhe kufizimet përkatëse.</p> |
| Faza 3 | <p>Rekomandohet evitimi i përfaqimeve dhe shtrëngimit të duarve;</p> <p>Rekomandohet ruajtja e distancës 2 m;</p> <p>Ndalesë e grumbullimeve masive të më shumë se 100 personave në mjediset të caktuara, sidomos të mbyllura dhe ku duhet të ruhet distanca 2 m.</p> <p>Lëvizje e lirë.</p> | <p>Çdo biznes apo institucion shtetëror apo jo, fillon aktivitetin por duke ruajtur rregullat e distancimit fizik</p> <p>Mjetet e transportit publik fillojnë të funksionojnë dhe transporti lejohet.</p> <p>Do të lejohen taksitë brenda qytetit dhe ndër qytetase.</p> | <p>Masat e higjenes ne mjediset publike/private: pastrimi dhe dezinfetimi i cdo mjedisi publik/privat, shkallëve të pallateve, institucioneve.</p> <p>Institucionet e arsimit mbeten të mbyllura por sistemi parashkollor rihapet duke ruajtur masat e distancimit fizik.</p> <p>Në këtë fazë në varësi të kushteve epidemiologjike dhe vlerësimit të rreptë të masave konsiderohet hapja e restoranteve, bareve, palestrave, aktivitetve sportive pa spektatorë.</p> |
| Faza 4 | <p>Rikthim në normalitet.</p> <p>Rekomandohet ndjekja e masave të higjienës personale.</p> | <p>Rikthim në normalitet.</p> <p>Rekomandohet ndjekja e masave të higjienës personale dhe rregullat e distancimit fizik ne ambientet e punës.</p> | <p>Rikthim në normalitet</p> <p>Institucionet arsimore fillojnë të funksionojnë.</p> <p>Rekomandohet ndjekja e masave të higjenes ne mjediset publike/private.</p> |

KAPITULLI 3

Sistemi shëndetësor

Të gjitha udhëzimet dhe masat kufizuese të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Aneksi 1) mbi ofrimin e kujdesit shëndetësor në periudhën e pandemisë, patën si qëllim ruajtjen e shëndetit publik të popullatës, fitimin e njohurive epidemiologjike në lidhje me virusin, uljen e përhapjes së COVID-19, të sëmundjeve shoqëruese të saj, uljen e kurbës së infeksionit si dhe zvogëlimin e kontakteve nëpërmjet distancimit social.

Masat e marra ndikuan ndjeshëm në zvogëlimin e përhapjes së virusit, bazuar kjo dhe në treguesit e deritanishëm, megjithatë, qëllimi i rishikimit tashmë të masave nuk është më për të ndaluar pandeminë, por për ta ngadalësuar atë akoma më tepër.

3.1 Fuqizimi i sistemit shëndetësor si rezultat i Planit të Veprimit kundër COVID-19

Bazuar në rezultatet e dala nga zbatimi me rreptësi i masave dhe vendimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare, i urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i Planit të Veprimit kundër COVID-19, rezulton se të gjithë treguesit shëndetësor të popullatës kanë një efekt pozitiv, bazuar kjo, edhe në shifrat e lartpërmendura, në formën e tyre tabelare në kapitujt e lartpërmendur.

Menaxhimi strategjik i sistemit shëndetësor në periudhën COVID-19 në Shqipëri, bazuar në vendimet strategjike, politikat e reja shëndetësore, u realizua nëpërmjet zbatimit të planit të veprimit kundër COVID-19, të cilat lidhen me:

- Ngritjen e Task Forcës, për parandalimin e infeksionit të përhapur nga Koronavirusi.
- Marrjen në kohë të masave higjieno sanitare, për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute, përfshire dhe COVID - 19 në sistemin arsimor si, kopshte, çerdhe, shkolla, univeristete etj.
- Miratimin e protokolleve dhe masat ndaj koronavirusit nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.
- Miratimin e protokolleve dhe algoritmeve për parandalimin e sëmundjes COVID-19 në Shqipëri.
- Miratimin e listës së sëmundjeve infektive të detyrueshme për t'u raportuar nga institucionet shëndetësore, publike, private në Shqipëri.
- Ndalimin e eksportit të barnave dhe pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë.
- Ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të karantinës në mjedise të përcaktuara.

- Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike si dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura në Shqipëri.
- Kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve në spitale.
- Vetëkarantinimin e personave që hynë në territorin e Shqipërisë nga zonat e izoluara të Italisë apo dhe të rajoneve të tjera.
- Mbrojtjen dhe ruajtjen e të moshuarve duke parandaluar vizitat në shtëpitë e kujdesit të të moshuarve.
- Shmangien e kontakteve fizike me të tjerët për pensionistët-popullatën mbi moshën 65 vjeç, me qëllim kufizimin dhe respektimin e distancimit social.
- Marrjen e masave për parandalimin e infektimit ng COVID-19, të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Pezullimin e funksionimit të Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë për të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës.
- Ndërprerjen e udhëtimeve brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë (transport rrugor, ajror, detar dhe publik) me qëllim kufizimin e lëvizjes së popullatës.
- Ndalimin e tubimeve publike me më shumë se pesëdhjetë persona.
- Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”.
- Mbylljen e veprimtarisë së çerdheve, kopshteve, arsimit shkollor me qëllim kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.
- Krijimin e platformave dixhitale për arsimin në distancë për institucionet e edukimit të arsimit shkollor, të mesëm dhe arsimin e lartë para dhe pasuniversitar.
- Sigurimin e ndjekjes së pacientëve kronik në gjendje të stabilizuar nëpërmjet telemedicinës.
- Ofrimin e barnave me rimbursim në banesë për pacientët kronikë mbi 65 vjeç.
- Ofrimin e konsultave on-line për pacientët kronikë në gjendje të stabilizuar me qëllim kufizimin e grumbullimit të tyre mjediset e strukturave shëndetësore.
- Fuqizimin e spitaleve me shtretër të kujdesit intensiv.
- Sigurimin me mjete mbrojtëse personale për spitalet.
- Fuqizimin e kapaciteteve spitalore me respiratorë.
- Sigurimin e spitaleve me pajisje mjekësore (monitorë spitalorë, defibrilatorë, nebulizatorë).
- Plotësimin e nevojave spitalore me analizat laboratorike imunologjike, përfshirë kite reagentë dhe tamponë për PCR.
- Plotësimin e nevojave spitalore me barna mjekësore.
- Hartimin e protokollit mjekësor COVID-19 për pacientët e shtruar në spital.
- Menaxhimin e mbetjeve spitalore të shkaktuar nga COVID-19.
- Trajnimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor për:
 - faktorët e njohur të rrezikut të COVID-19
 - simptomat klinike dhe shenjat e COVID-19
 - procedurat e raportimit, transferimit të personave nën hetim
 - procedurat e ndjekjes për rastet e e konfirmuara

3.2 Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

QKUM, si një nga institucionet unike me përgjegjësinë për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet misioneve në banesë ka luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin, përgatitjen dhe përgjigjen ndaj rasteve të identifikuar me COVID 19.

Roli i QKUM, për t'ju përgjigjur në kohë reale të gjitha shërbimeve të qytetarëve u realizua në zbatim të planit të veprimit për parandalimin, përgatitjen dhe përgjigjen kundër COVID-19, nëpërmjet:

- Thirrjeve të qytetarëve në numrin unik 127
- Këshillimeve të qytetarëve në linjën e gjelbër 0800 40 40
- Ofrimit të shërbimit në banesë
- Dërgimin në spital sipas protokolleve të hartuara

Duke qenë se, pandemia e koronavirusit ishte dhe është një ngjarje që ndryshojë qasjen e popullatës ndaj shërbimeve shëndetësore në të gjithë botën, po kështu dhe në vendin tonë, kalimi gradual në fazën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore me kapacitete të plota në nivelin parësor, dytësor dhe terciar do të shoqërohet nga disa veprime strategjike që lidhen me mënyrën e ofrimit të shërbimeve në kujdesin parësor dhe atë spitalor.

Gjatë këtyre fazave të përcaktuara në strategji, bashkëpunimi, bashkërendimi i integruar midis institucioneve shëndetësore do të vijojë të ketë si qëllim, rritjen e qëndrueshmërisë, aksesit, besueshmërisë, ndërgjegjësimit për grupet në risk, mbrojtjen e grupeve vulnerabël nga cdo komplikacion shëndetësor, si dhe plotësimin e nevojave të popullatës për akses të plotë në të gjitha shërbimet shëndetësore.

Institucionet përgjegjëse për ruajtjen e shëndetit të popullatës do të vijojnë të përcaktojnë nivelin e riskut, përforcimin e survejancës respiratore akute, pneumonive akute, përgatitjen e përkufizimit të rasteve, udhëzimet për survejancën, vazhdimësinë e hetimit epidemiologjik në bashkëpunim me të gjithë institucionet shëndetësore ashtu sic kundër u veprua në zbatim të planit të veprimit.

3.3 Plani i masave të ofrimit të shërbimit shëndetësor

Plani i masave të ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor do të lidhet me zgjerimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të cilat deri në këtë moment janë menaxhuar në zbatim të skenarëve të parashikuar në planin e veprimit dhe në përputhje me situatën në vend.

- Rivendosja e shërbimeve të kujdesit shëndetësor sipas niveleve të tij, të aksesueshme fizikisht për popullatën, që ka nevojë për përdorimin e tyre.
- Vazhdimi i ofrimit të informacionit dhe trajnimit në vazhdim të profesionistëve të kujdesit shëndetësor për masat e nevojshme të ruajtjes së higjienës.
- Vazhdimi i këshillimit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse në strukturat e kujdesit parësor dhe spitalor nga personeli mjekësor.
- Vazhdimi i testimit, të gjurmimit të koordinuar, në shkallë të gjerë dhe të rajonalizuar, për të monitoruar përhapjen e virusit dhe rritjen e imunitetit në popullatës.
- Rihapja dhe përdorimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor në përputhje dhe në respektim me fazat e strategjisë.
- Rajonet, bashkitë, njësitë administrative me shkallë më të ulët infeksioni dhe më me pak mundësi për përhapje të virusit mund të ofrojnë shërbimet e tyre shëndetësore në të gjitha nivelet me kapacitete të plota, gradualisht dhe në interval kohe të ndryshme, më lehtë se një rajon apo një bashki tjetër.

Të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor do të vazhdojnë të jenë përgjegjës për vlerësimin e shërbimeve që do të ofrohen, si dhe të zbatimit të protokolleve dhe udhëzimeve përkatëse sipas cdo rasti.

3.3.1 Shërbimi Parësor

Kujdesi parësor, do të ofrojë të gjitha shërbimet shëndetësore të nivelit parësor me fillimin e fazës së parë të strategjisë, duke ofruar kështu, konsultat, vizitat, ekzaminimet laboratorike, imazherike për të gjithë ata pacientë që kanë nevojë për përdorimin fizik të shërbimeve të kujdesit parësor.

3.3.2 Shërbimi Spitalor

Kujdesi spitalor, në nivelin dytësor dhe terciar, do të mundësojë në mënyrë graduale ofrimin e të gjitha shërbimeve spitalore duke respektuar fazat e strategjisë.

Kujdesi spitalor, do të ofrojë shërbimin ambulator, shërbimin e urgjencës dhe shërbimin me shtretër për të gjithë ata pacientë që kanë nevojë për përdorimin fizik të shërbimit spitalor.

3.4 Fazat e sistemit shëndetësor

Bazuar dhe në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë si dhe në vlerësimin epidemiologjik të treguesve të Shqipërisë, sistemi shëndetësor do të ofrojë shërbimet e kujdesit shëndetësor duke kaluar në katër (4) fazat e strategjisë.

| Faza e parë (1) | Faza e dytë (2) | Faza e tretë (3) | Faza e katërt (4) |
|---|---|---|--|
| <p>Kujdesi Parësor:</p> <p>Përditësim të sistemit elektronik në lidhje me COVID-19</p> <p>Nis gradualisht planifikimi vizitave në parësor</p> <p>Shtrirje graduale e referimeve tek mjeku specialist</p> <p>Shtrirje graduale e planifikimit të ekzaminimeve terciare</p> <p>Kujdesin Spitalor:</p> <p>Shtrirja graduale e konsultave ambulatorore</p> <p>Shtrirje graduale e planifikimit të ndërhyrjeve ambulatorore</p> <p>Shtrirje graduale e planifikimit të mikrokirurgjive, ndërhyrjeve invazive etj.</p> <p>Sistemi shëndetësor ofron të gjitha shërbimet në kujdesin parësor</p> | <p>Shëndeti publik:</p> <p>Planifikimi i programeve të depistimit, parandalimit në qarqet e paprekura</p> <p>Kujdesi Spitalor:</p> <p>Spitalet rajonale të paprekura ofrojnë të gjitha shërbimet</p> <p>Spitalet rajonale të prekura ofrojnë shërbime të planifikuara</p> <p>Spitalet universitare ofrojnë ndërhyrjet kirurgjikale të planifikuara</p> <p>Sistemi shëndetësor ofron disa prej shërbimeve kirurgjikale</p> | <p>Kujdesi Spitalor:</p> <p>Planifikimi i të gjitha ndërhyrjeve kirurgjikale spitalore</p> <p>Sistemi shëndetësor ofron të gjitha shërbimet në kujdesin spitalor</p> | <p>Sistemi shëndetësor ofron të gjitha shërbimet shëndetësore</p> <p>Sistemi shëndetësor ofron të gjitha shërbimet</p> |

Tabela 2 Fazat e rihapjes së sistemit shëndetësor

*Fazat e përshkuara më sipër janë në përputhshmëri me nivelin e riskut

3.5 Masat e komunikimit për ofrimin e kujdesit shëndetësor

Masat e komunikimit dhe të ofrimit të informacionit të gjithë qytetarëve që kanë nevojë, kërkesa për të përdorur fizikisht shërbimet e kujdesit shëndetësor:

- Sigurimi i aksesit për qasje fizike në shërbimin parësor dhe spitalor
- Rritja dhe formësimi i vetëdijes për qytetarët që ekziston ende mundësia e shpërthimeve të mëtejshme dhe e vazhdimësisë së pandemisë
- Rritja e kujdesit duke respektuar rregullat dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse personale në mjediset e kujdesit parësor dhe spitalor.
- Sigurimin që publiku e ka kuptuar që virusi ende qarkullon dhe, se për këtë arsye, ata duhet të vazhdojnë të jenë të vetëdijshëm për masat për të mbrojtur veten e tyre në një nivel individual.

KAPITULLI 4

Vlerësimi i riskut dhe rekomandimet për lehtësimin e masave për biznesin

Për të vlerësuar dhe rekomanduar lehtësime në lidhje me rifillimin e ushtrimit të aktivitetit të bizneseve, sipas kategorive të përcaktuara është e rëndësishme që hapat e e hapjes së bizneseve të ndjekin fazat e përcaktuara në strategji.

Hapja e bizneseve do të jetë gjithmonë në përputhje me masat e strategjisë duke respektuar udhëzimet dhe vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Bazuar në tipologjinë që cdo biznes ka si dhe në analizimin e tyre sipas tipologjive u hartua lista e bizneseve sipas një klasifikimi në bazë të nivelit të riskut i shoqëruar ky klasifikim me ngjyrën përkatëse.

Kategoria e parë jeshile: paraqet bizneset që mund të fillojnë punën në fazën e parë duke plotësuar kushtet paraprake.

Kategoria e dytë e verdhë: paraqet bizneset që mund të rifillojnë perfundimisht nga puna pas përmbushjes së disa kushteve specifike.

Kategoria e tretë e kuqe: paraqet bizneset që shfaqin risk më të lartë e për të cilat do të gjykohet në bazë të zhvillimit të situatës.

Rekomandimet në lidhje me lehtësimin e masave të fillimit të ushtrimit të aktivitetit ekonomik të institucioneve dhe bizneseve lidhen me:

- Zbatimin e masave të higjenës në mjediset e aktivitetit që ushtrohet.
- Respektimin e distancimit fizik.
- Ndalimin e grumbullimeve masive të qytetarëve brenda dhe jashtë biznesit.
- Përdorimin e mjeteve mbrojtëse personale.
- Përdorimin e masave higjieno sanitare nga personeli i biznesit.
- Funkcionimin me orar të përcaktuar për të kufizuar grumbullimin e qytetarëve.

4.1 Përcaktimi i kategorive të riskut

Duke qënë se nuk ka mjaftueshëm të dhëna dhe sisteme të sakta në bazë të të cilave mund të stratifikohen dhe klasifikohen bizneset në bazë të nivelit të riskut që paraqesin, ky dokument bën një vlerësim të riskut për disa kategori kryesore të bizneseve mbi 3 parametra.





Parametri i parë është intensiteti i kontakteve i cili është një kombinim i llojit të kontaktit (afër ose larg) dhe kohëzgjatjes (shkurtazi apo për periudha të zgjatura). Intensiteti i kontaktit mund të variojë nga i ulët, në i mesëm ose i lartë.

Parametri i dytë ku është bazuar vlerësimi i riskut është numri i kontakteve që paraqet një mesatare personash që mund të frekuentojnë një biznes të caktuar në të njëjtën kohë, dhe që kategorizohet si i ulët, i mesëm ose i lartë.

Së fundmi, parametri i tretë është ai i potencialit që një biznes ka për të kryer përshtatje në strukturë apo mënyrë operimi (që variojnë nga masa administrative, në mjete mbrojtëse personale, në masa dhe përshtatje që promovojnë distancimin fizik) për të reduktuar riskun. Edhe ky parametër, në varësi të tipologjisë së biznesit, mund të cilësohet i ulët, i mesëm ose i lartë.

Në bazë të këtyre tre parametrave, bizneset kategorizohen dhe janë subjekti i aplikimit të protokollëve jeshil, të verdhë ose të kuq. Si parim, bizneset apo sektorët që kanë intensitet të ulët të kontakteve, numër të ulët të kontakteve dhe shfaqin potencial për të kryer lehtësisht përshtatjet e nevojshme, renditen me shkallë më të ulëta të nivelit të riskut dhe mund të rinisin nga puna më herët se sa ato që kanë intensitet dhe numër të lartë kontaktesh apo pamundësi ose vështirësi për të implementuar masat e nevojshme. Për shembull, tabela më poshtë tregon kategorizimin e disa bizneseve në bazë të këtij sistemi.

Tabela 3 Sistemi i përcaktimit të nivelit të riskut sipas 3 parametrave të sipërpërmendura

| Kategoria | Intensiteti i kontaktit | Numri i kontakteve | Potenciali i modifikimit | Niveli i riskut |
|---|-------------------------|--------------------|--------------------------|---|
| Sallone, SPA, palestra, biznese të tjera të kujdesit trupor | I mesëm | I ulët | I mesëm |  |
| Dyqane me pakicë | I ulët | I ulët | I mesëm |  |
| Qendra tregëtare | I ulët | I mesëm | I mesëm |  |
| Mjedise të hapura me kapacitet të lartë | I lartë | I lartë | I mesëm |  |

4.2 Protokollet sipas nivelit të riskut

Bazuar në përcaktimin e aktivitetit të bizneseve sipas kategorive të riskut, këto biznese janë klasifikuar sipas tre niveleve të riskut.

- Protokoli i riskut të ulët (jeshil)
- Protokoli i riskut të mesëm (i verdhë)
- Protokoli i riskut të lartë (i kuq)

Duke u bazuar në përcaktimin e kategorive të riskut për bizneset që kryejnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë, këto të fundit janë klasifikuar sipas klasave në tre nivele risku: të ulët (jeshil), të mesëm (të verdhë) dhe të lartë (të kuq). Në përputhje me kategorinë e riskut ku bën pjesë secili biznes janë hartuar protokollet përkatëse të përmbledhura në Aneksin 2.

Në figurën e mëposhtme paraqitet gjithashtu një përmbledhje e protokolleve të bizneseve dhe aktiviteteve të natyrave të ndryshme, sipas shkallës së riskut që ato paraqesin.

Tabela 4 Protokolle të bizneseve dhe aktiviteteve sipas shkallës së riskut

| Protokolli Jeshil | Protokolli i Verdhë | Protokolli i Kuq |
|--|--|---|
| <p>Sektori bujqësor, industrial, blegtoral dhe ai i peshkimit, industria nxjerrëse dhe përpunuese si dhe sektori i ndërtimit.</p> <p>Tregtia me shumicë dhe shitja e produkteve elektronike, elektro-shtëpiaket, etj.</p> <p>Aktivitetet e tregtisë me shumicë të mobiljeve dhe të produkteve të kozmetikës.</p> <p>Aktivitetet e pikave të shumicës së qilimave dhe produkteve të orëve dhe bizhuterive, etj.</p> | <p>Aktivitetet e organizatave fetare politike apo edhe aktiviteteve ekonomike.</p> <p>Aktivitetet prodhuese/përpunuese me 25-50 persona në një mjedis zbatojnë protokollin e verdhë.</p> <p>Aktivitetet si kultivim, përpunim, prodhim të produkteve bujqësore dhe blegtorale me mbi 25 persona që punojnë në ferma/ambiente të mbyllura dhe që zbatojnë protokollin e verdhë.</p> | <p>Sektori arsimor.</p> <p>Qendra të kujdesit social për të moshuar dhe të personave pak aftësi fizike</p> <p>Baret, klubet e natës, call center, fasoneri apo ato biznese që shfaqin kontakt të afërt midis punonjësve apo klientëve.</p> <p>Funksionimi i strukturave sportive.</p> |
| RISK I ULËT | RISK I MESËM | RISK I LARTË |

KAPITULLI 5

Monitorimi i situatës

Me lehtësimin e masave, për të garantuar se situata është nën kontroll e nuk ka një shtim të numrit të rasteve apo rritje të përhapjes së virusit është e nevojshme që të monitorohen vazhdimisht e me kujdes disa drejtime:

- Duhet të vazhdojë të zbatohet e të përmirësohet edhe më tej sistemi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave mbi përhapjen e virusit, si edhe të ofrohet një informacion më i detajuar mbi personat e infektuar dhe të shëruar.
- Duhet të krijohen ekipet e dedikuara të terrenit për hetimin epidemiologjik.
- Duhet të rritet mbulimi i kontakteve deri në 90%.
- Duhet të përmirësohet dhe zgjerohet kapaciteti i testimit si edhe të harmonizohen metodologjitë e testimit. Gjithashtu mund të hartohen skema apo protokollë testimi për prioritizimin e testimit, për të investiguar imunitetin e fituar në popullatën e gjerë, etj.
- Duhet të vazhdojë rritja dhe forcimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të kujdesit shëndetësor për të garantuar dhënien e kujdesit të duhur për të infektuarit me SARS-CoV-2, por edhe për të gjithë pacientët e tjerë.
- Duhet të vazhdojë të sigurohet rritja e stokut për mjetet mbrojtëse personale (MMP) për të garantuar mbrojtjen e stafit mjekësor.
- Duhet të vijojë të intensivikohet sistemi sindromik si edhe të jenë aktive përgjatë të gjithë vitit qendrat sentinel të survejancës së gripit.

5.1 Monitorimi intensiv i situatës epidemiologjike dhe mekanizmat e frenimit të fazave të rihapjes

Sic është nënvizuar në seksionin e mëparshëm të kësaj strategjie, procesi i përparimit në fazat e normalizimit nuk është i parikthyeshëm. Ai do të varet nga efekti i masave të përshtatura dhe reflektimi i tyre në tregues të ndryshëm të monitorimit të situatës së riskut nga COVID-19.

Një sërë treguesish do të vijojnë të maten në menyrë sistematike për këtë qëllim.

Në skemën e mëposhtme jepet forma e mekanizmit të përparimit të kujdesshëm apo frenimit nëse është e nevojshme, në fazat drejt rihapjes së situatës.

Tabela 5 Skema e përparimit të kujdesshëm në fazat e rihapjes dhe mekanizmi i monitorimit

| RISK I ULËT | RISK I MESËM | RISK I LARTË |
|--|---|--|
| <p>Nën 12 raste të reja të diagnostikuara në ditë (e llogaritur mbi mesataren javore) me prirje për ulje, për dy javet e fundit</p> <p>dhe/ose më pak se 90 pacientë të shtruar me COVID-19 gjithsej</p> <p>dhe/ose më pak se 10-15 pacientë në reanimacion gjithsej</p> | <p>13 – 25 raste të reja të diagnostikuara në ditë (e llogaritur mbi mesataren javore) me prirje për rritje, për dy javet e fundit</p> <p>dhe/ose 91 – 150 pacientë të shtruar me Covid-19 gjithsej</p> <p>dhe/ose 16 - 25 pacientë në reanimacion gjithsej</p> | <p>Mbi 25 raste të reja të diagnostikuara në ditë (e llogaritur mbi mesataren javore) me prirje për rritje, për dy javet e fundit</p> <p>dhe/ose mbi 150 pacientë të shtruar me Covid 19 gjithsej</p> <p>dhe/ose mbi 25 pacientë në reanimacion gjithsej</p> |
| <p>VIJOHET ME FAZAT E STRATEGJISË SË RIHAPJES</p> | <p>FRENOHET PËRPARIMI NË FAZËN E DYTË TË RIHAPJES</p> | <p>KTHEHEMI MENJËHERË TE MASAT DRASTIKE</p> |

*Risku është në përputhje edhe me skenarët e parashikuar në planin e veprimit.

Në skemën e mësipërme jepet forma e mekanizmit të përparimit të kujdesshëm apo frenimit nëse është e nevojshme, në fazat drejt rihapjes së situatës.

Treguesit bazë që do të analizohen për të vlerësuar nivelin e riskut për infeksionin nga COVID-19 dhe presionin mbi sistemin shëndetësor janë:

- Numri i rasteve të reja të diagnostikuara
- Numri i shtrimeve spitalore
- Numri i pacientëve nën kujdes intensiv

Në rastin se nuk do të ketë më shumë se 12 raste të reja në ditë (e përlllogaritur si mesatare e rasteve javore) përgjatë dy javëve, ndërkohë që prirja është në ulje, e kombinuar kjo me një numër jo më të madh se 90 rastesh të shtruar dhe jo më shumë se 10-15 rastesh në kujdes intensiv, risku do të konsiderohet i ulët lidhur me COVID-19 dhe do të vijohet me përparimin sipas programit në fazat e rihapjes.

Rritja e numrit të rasteve të reja në mbi 13-25 në ditë për dy jave dhe/ose rritje e të shtruarve dhe pacientëve në reanimacion, respektivisht nga 91-150 dhe mbi 16-25, do të konsiderohen një sinjal alarmi për të frenuar përkohësisht përparimin në fazat e rihapjes.

Një rritje e rasteve mesatarisht mbi 25 raste të reja në ditë, për dy javët e fundit, e shoqëruar me rritje të të shtruarve mbi 150 dhe pacientëve në gjendje kritike mbi 25, do të konsiderohet si një sinjal i fortë për t'u kthyer mbrapsht, në fazën e mbylljes.

Gjithsesi, ky është vetëm një prej sistemeve të monitorimit apo kontrollit të përparimit në fazat e rihapjes. Një sërë vlerësimesh të tjera, të tilla si përhapja e vatrave të infeksionit në vend, të dhënat e survejancës sindromike mbi infeksionet respiratore, apo prirjet ndërkombëtare, do të shërbejnë gjithashtu për të orientuar vendimarrjen hap pas hapi në këtë fazë të kontrollit të pandemisë.

KAPITULLI 6

Konkluzione

Bazuar në principet dhe kriteret e përmendura më sipër lehtësimi i masave shtrënguese mund të fillojë zbatimin pas një analize të thelluar shkencore që mbështetet nga faktet shkencore dhe parimet epidemiologjike.

Gjithsesi, për të kontrolluar dhe mbajtur nën kontroll situatën, është e rëndësishme të zbatohen rekomandimet e mëposhtme në çdo hap.

- Vendimet e marra për lehtësimin e masave do të jenë graduale dhe do të jepet kohë ndërmjet fazave të ndryshme (minimumi 2 javë, kohë që përkon edhe me periudhën e inkubimit të virusit) duke qënë se efektshmëria dhe ndikimi i tyre mund të matet vetëm në periudha të zgjata kohore.
- Masat e përgjithshme do të zëvendësohen nga ato më të targetuara, duke lejuar kthimin në normalitet por njëkohësisht edhe mbrojtjen e popullsisë.
 - Grupet më vulnerabël do të mbrohen për periudha më të gjata kohore.
 - Personat e konfirmuar apo ata me simptoma të lehta do të vazhdojnë të qëndrojnë të karantinuar.
 - Masat shtrënguese do të fillojnë të zëvendësohen gradualisht me alternativa më të gjera por të sigurt (p.sh. disinfektimi i vazhdueshëm i mjeteve të transportit publik dhe ruajtja e distancave të sigurisë, në vend të ndalimit të plotë).
- Lehtësimi i masave shtrënguese mund të nisi në rajone të caktuara dhe të zbatohet më pas në të gjithë vendin nëse kjo gjykohet e drejtë në bazë të situatës epidemiologjike në vend.
- Rifillimi i aktiviteteve ekonomike do të bëhet gradualisht dhe në faza duke garantuar kështu që të gjitha bizneseve t'u jepet koha e nevojshme për të hartuar strategjitë e nevojshme dhe për të rifilluar aktivitetet e plota duke garantuar sigurinë e punonjësve.
- Grumbullimet e njerëzve do të lejohen në shkallë progresive, duke u fokusuar në veçoritë e ndryshme të aktiviteteve të ndryshme, si:
 - Shkollat dhe universitetet (vendosja e masave specifike si oraret e ndryshme për pushimin e drekës, disinfektimi, zhvillimi i mësimit në klasa më të vogla, etj.);
 - Aktivitetet tregëtare me përshkallëzim të ndryshëm (p.sh. numri i njerëzve të lejuar në mjediset e brendshme, etj.);
 - Masat në lidhje me eventet sociale (restorante, kafe, etj.) duhen përshkallëzuar (në lidhje me oraret e funksionimit, numrit të njerëzve të lejuar, distancat midis individëve, etj.);
 - Grumbullimet masive (p.sh. festivale, ndeshje sportive, etj.).
- Do të investohet vazhdimisht në luftën për parandalimin e përhapjes së virusit duke nxitur popullatën të ruajë higjenën personale, të zbatojë rregullat e komunikuara

përgjatë kësaj periudhe pandemie, si edhe të praktikojë aty ku mundet parimin e distancimit social.

- Lehtësimi i masave do të monitorohet në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme duke përdorur parimet e sipërpërmendura si edhe do të aktivizohen mekanizmat frenues që kanë për synim riaplikimin e masave më të rrepta nëse indikatorët orientojnë drejt kësaj të fundit.
- Ky udhërrëfyes është i një natyre dinamike. Parimet dhe parametrat mbeten të njëjtë, por skenarët dhe planifikimet mund të rishikohen në përputhje me zhvillimet dhe mbarëvajtjen e situatës.

KAPITULLI 7

Referenca

1. MSHMS. Plan Veprimi per Shqiperine, paraqitje, pergatitje dhe pergjigje kunder COVID-19, Mars 2020.
2. ECDC. Outbreak of novel coronavirus disease 2019 (COVID-2019): increased transmission globally - fifth update. March 2020.
3. WHO. COVID-19 Strategic Preparedness and Response Plan/ Operational planning guidelines to support country preparedness and response. February 2020.
4. ECDC. Outbreak of novel coronavirus disease 2019 (COVID-2019): increased transmission globally - fifth update. March 2020.
5. WHO. COVID-19 Strategic Preparedness and Response Plan/ Operational planning guidelines to support country preparedness and response. February 2020.
6. European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC). Case definition and European surveillance for human infection with novel coronavirus (2019-nCoV) 2020. Available from: <https://www.ecdc.europa.eu/en/case-definition-and-european-surveillance-human-infection-novelcoronavirus-2019-ncov>.
7. World Health Organization (WHO). WHO Statement Regarding Cluster of Pneumonia Cases in Wuhan, China Geneva2020 [cited 2020 29 February]. Available from: <https://www.who.int/china/news/detail/09-01-2020-who-statement-regarding-cluster-of-pneumonia-cases-in-wuhan-china>.
8. World Health Organization (WHO). Global Surveillance for human infection with novel coronavirus (2019- nCoV) 2020 [21 January 2020]. Available from: https://www.who.int/docs/defaultsource/coronaviruse/20200121-global-surveillance-for-2019-ncov.pdf?sfvrsn=9d82f528_4&download=true.
9. European Commission (EC). COVID-19 [cited 2020 1 March]. Available from: https://ec.europa.eu/health/coronavirus_en.
10. World Health Organization (WHO). Coronavirus disease (COVID-19) outbreak [cited 2020 1 March]. Available from: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019>.
11. World Health Organization. (2020). Considerations in adjusting public health and social measures in the context of COVID-19: interim guidance, 16 April 2020. World Health Organization.

Aneksi 1

Veprimet e ndërmarra në strategjinë e kufizimit të përhapjes së COVID-19

10.03.2020

- Dërgimi i pensioneve për të moshuarit pa kosto ekstra, duke filluar nga ky muaj e deri në përfundimin e kësaj situate
- Mbledhja masive e personave në vende publike është e ndaluar, dhe në çdo rast distanca nga personi në person nuk duhet të jetë më pak se një metër.
- Mbyllja e vendeve publike deri në 3 Prill, të gjitha objektet që ofrojnë shërbime të tilla si disko, klube të natës, vende argëtuese për të rinjtë si qendra sociale, palestra, pishina.
- Kufizimi i kontakteve në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike. Për qendrat sociale që ofrojnë shërbime për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa mbështetje prindërore, kontakti me persona jashtë strukturës ku ata banojnë do të shmanget.
- Restorantet dhe baret mund të ofrojnë shërbime për qytetarët duke respektuar distancën së paku 2 metra nga tryezat dhe të paktën 1 metër qytetarë nga njëri-tjetri.
- Autoritetet e shërbimit postar duhet të sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe të hartojnë një plan masash për të shmangur kontaktin e personelit me publikun.
- Punëdhënësit privatë të marrin masa për të parandaluar përhapjen e virusit. Të shmanget kontakti me publikun nëse shërbimi mund të ofrohet në internet.
- Të gjitha proceset dhe procedurat për vendet e lira të punësimit do të pezullohen përkohësisht.

12.03.2020

- Ndalimi i trafikut të automjeteve private dhe urbane nga Tirana në Durrës nga ora 6 e mëngjesit të Premten në 13.03 deri të Dielën 15.03.
- Ndalimi i qarkullimit të automjeteve private dhe urbane në Shkodër, Lezhë, Elbasan, Lushnjë, Fier, Vore nga ora 6 e mëngjesit të Premten në 13.03 deri të Dielën 15.03.

14.03.2020

- Mbyllet Kufiri me Greqinë për udhëtarët.
- Qarkullimi i automjeteve lejohet deri në orën 8 të mëngjesit. dhe 4 deri në 5 pasdite.

15.03.2020

- Kufiri me Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën mbyllet për udhëtarët.
- Akti Normativ, Nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave specifike administrative

gjatë periudhës së infeksionit të COVID-19”, Këshilli i Ministrave.

- Në varësi të dinamikës së shtrimit në spital të personave të prekur nga infeksioni COVID-19, spitalet private, shërbimet ambulatorë, ambientet e akomodimit, auto-ambulancat dhe personeli përkatës shëndetësor dhe ndihmës do të vihet në dispozicion të MSHMS për t’u përballur me COVID -19.
- Subjektet që eksportojnë ilaçe dhe pajisje mjekësore nga Republika e Shqipërisë, pa autorizimin special të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dënohen (5,000,000 lekë) dhe nëse përsëritet veprimtaria e eksportit të ilaçeve dhe pajisjet mjekësore do të ndalohet veprimtaria deri në 6 muaj).
- Hyrja e të njohurve të pacientëve dhe / ose anëtarëve të familjes në institucionet e urgjencës mjekësore, ambientet e kujdesit shëndetësor, ambientet e shërbimit spitalor ku pacientët janë duke marrë trajtim është e ndaluar, përveç nëse një kërkesë e tillë vjen nga Drejtoria e Spitalit (mosrespektimi i këtij detyrimi do të jetë ndëshkohet me 500,000 lekë).
- Autoritetet e shërbimit postar sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe hartojnë një plan masash për të kufizuar kontaktin e punonjësve me publikun dhe për të shmangur grumbullimin në banak ose ambiente të tjera. (mosrespektimi i këtij detyrimi dënohet me 1,000,000 dhe nëse përsëritet, veprimtaria do të pezullohet për një periudhë prej gjashtë muajsh).
- Duhet të merren masa të menjëhershme për të ndaluar grumbullimin e pacientëve në struktura të mbyllura të institucioneve të kujdesit shëndetësor, poliklinika, spitale, publike dhe jopublike, ku kryhen vizita dhe konsulta ambulatorë (mosrespektimi i dënimit dënohet me 1 000 000 lekë dhe nëse përsëritet, veprimtaria e tyre do të pezullohet për një periudhë prej gjashtë muajsh).
- Rritja e çmimit të shitjes së të gjitha produkteve ushqimore, ilaçeve, mjeteve mjekësore dhe shërbimeve, kur nuk vjen nga rritja e çmimit nga importi i tyre, do të dënohet (Mosrespektimi dënohet me 5 000 000 - 100 000 lekë dhe nëse përsëritet, veprimtaria e tyre do të pezullohet për një periudhë prej gjashtë muajsh).
- Të gjitha transmetimet audiovizive me më shumë se dy persona në të njëjtin studio televizive do të dënohen (mosrespektimi do të dënohet me 1 000 000 lekë dhe nëse përsëritet, transmetimi në media do të bllokohet në mënyrë të pjeshme ose të plotë).
- Farmacitë, shitësit me shumicë dhe prodhuesit e ilaçeve, që nuk zbatojnë kriteret e sigurisë të përcaktuara nga autoritetet kompetente, do të dënohen (mosrespektimi do të dënohet me 10 000 000 deri në 50 000 lekë dhe nëse përsëritet, bllokimi i të gjithë sasisë së mallrave dhe mbyllja e veprimtarisë për 3 vjet).

16.03.2020

- Mbyllen fluturimet me Mbretërinë e Bashkuar.
- Duke filluar nga 16.03, nga ora 18:00 e tutje, lëvizja e këmbësorëve është e ndaluar në të gjithë vendin. Lëvizja për të blerë ose ilaçe është e lejuar, sipas deklaratës së kryeministrit përmes mediave sociale. Kjo mund të specifikohet më tej nga autoritetet

përkatëse më vonë.

- Vendosjen e gjobave për shkelje të kufizimeve nga këmbësorët, përfshirë ndalimin e qarkullimit pas orës 18:00 ose shëtitjen në parqe dhe zona të tjera të hapura.
- Qeveria mund të nxjerrë një kufizim tjetër që ndalon të dalin të moshuarit; kjo do të specifikohet në një moment të mëvonshëm.
- Sa i përket masave të shpallura më parë, lëvizja me makina të qytetarëve duhet të bëhet me lejen e policisë vetëm sipas afatit të lejuar kohor / kategorive të përcaktuara.
- Trajnim i personelit shëndetësor në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë në Tiranë, dhe Universitetet e Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Vlorës dhe QSUT. Pjesëmarrësit do të jetë i gjithë stafi mjekësor i Spitaleve Universitare, Spitaleve Rajonale dhe Spitaleve Bashkiake (Urdhri Nr. Prot: 180; datë 16.03.2020).

18.03.2020

- Ndalimi i lëvizjes së automjeteve private dhe shtetërore të administratës publike. Përfshihen nga ky urdhër personeli i autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe personeli mjekësor (Urdhri Nr. Prot 168/2; dt. 18/03/20);
- Kufizimi i lëvizjes së këmbësorëve. Ata lejohen të lëvizin vetëm midis orës 6:00 dhe 10:00 dhe 16:00 - 18:00.

19.03.2020

- 25 milion USD për të mbështetur stafin shëndetësor dhe sektorët e shëndetit.
- 100 milion USD për të mbështetur kompaninë në nevojë për pagesa të punëtorit të tyre.
- 6.5 miliardë lekë për të mbështetur grupin e cenueshëm dhe biznesin e vogël.
- 2 miliardë lekë për të mbështetur Ministrinë e Mbrojtjes për misionin humanitar Një miliard lekë për të mbështetur Këshillin e Ministrave për çdo lloj emergjence Shtyrja e dorëzimit të detyrave financiare dhe institucioneve përgjegjëse.

20.03.2020

- “Reparti i Urgjencës Kirurgjikale” i Spitalit Universitar - Nënë Tereza është transferuar në Spitalin Universitar të Traumës me qëllim përmirësimin e aftësive të Spitalit Universitar Nënë Tereza për të menaxhuar rastet e COVID-19 dhe për të zvogëluar riskun.

21.03.2020

- MSHMS ka vënë në dispozicion një linjë të gjelbër 0800 40 40 FALAS për çdo qytetar që kërkon informacion ose këshilla në lidhje me COVID-19.
- Qytetarët mund të lëvizin nga ora 05:00 e mëngjesit deri në 13:00 në dyqane ushqimore,

farmaci, për shërbime bankare. Ky do të jetë dhe orari i punës në administratën publike.

- Të Dielën, 22/03/20, lëvizja e qytetarëve është e ndaluar.

24.03.2020

- Vendimi Nr. 243, datë 24.3.2020, Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë natyrore.

26.03.2020

- Qeveria ka vendosur të shndërrojë një ndërtesë ekzistuese në një Spital karantinë brenda 30 ditësh. Spitali i karantinës do t'u shërbejë atyre pacientëve që janë duke u rikuperuar, por ende duhet të monitorohen dhe të jenë të shtruar. Objekti do të ketë rreth 100 shtretër, një farmaci, një strukturë të asgjësimit të mbeturinave spitalore, një laborator imazherie dhe Instalime e oksigjeni.

03.04.2020

- Kufizimet e lidhura me COVID- 19 që përfundonin në 3 Prill u shtynë, dhe nëpërmjet nënshkrimit të urdhërave të rinj MSHMS i zgjat kufizimet deri në një datë të pacaktuar.

10.04.2020

- Afati kohor i lëvizjeve do të zgjatet deri në orën 17:30 dhe koha e lejuar do të jetë 90 minuta. Tregjet, bankat dhe farmacitë do të qëndrojnë të hapura deri në orën 17:30.
- Duke filluar çdo të Premte në ora 17:30 deri në ditën e hënë 05:00, të gjitha lëvizjet do të ndalohen. Ky regjim do të jetë në fuqi deri në një njoftim tjetër.
- Tregjet me pakicë ose me shumicë, farmacitë dhe bankat lejohen të operojnë nga ora 05:00 - 17:30.

Aneksi 2

Protokollet e masave sipas nivelit të riskut

| Niveli i Riskut | Protokolli i masave higjeno sanitare COVID-19 |
|-----------------|--|
| Niveli jeshil | <p>Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitete, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti.</p> <p>Person i caktuar nga administratori/personi fizik kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe të personave të punësuar nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127.</p> <p>Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar.</p> <p>Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të mbajë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.</p> <p>Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të përdorë dorezat mbrojtëse sipas këshillave.</p> <p>Në hyrje subjekti duhet të ofrojë produktin higjenzues të duarve për klientët dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60%.</p> <p>Klienti dezinfekton duart në hyrje dhe dalje nga subjekti. Klienti mban dorezat dhe maskën mbrojtëse sipas këshillave.</p> <p>Duhet të garantohet dhe respektohet në çdo moment distanca prej 2m midis klientit dhe personelit të punësuar.</p> <p>Punonjësi i arkës lan duart dhe i dezinfekton ato paraveshjes dhe pas zhveshjes se dorezave.</p> <p>Subjekti shërben vetëm një klienti në ambient, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në rradhë me distancë 2 metra nga njëri-tjetri. Në ambientet më hapësirë mbi 30 metra katrorë mund të lejohet proporcionalisht një klient tepër për çdo 10 metra katrorë shtesë ambienti duke orientuar klientët në ruajtjen e distancës.</p> <p>Subjekti duhet të afishojë në një vend të dukshëm në fasadë mundësinë e blerjeve online, mundësinë e rezervimit të takimit online apo me telefon.</p> |

Niveli i Riskut

Protokolli i masave higjensanitare COVID-19

Subjekti duhet të vendosë xham mbrojtës (ose plexiglass) klient shitës dhe shirit distance në banakun e arkës.

Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik shitës-klient.

Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes, sidomos të tavolinave, banaqeve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka patur kontakt prekje.

Subjekti duhet të sigurojë ajrim sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë. Ky detyrim për subjektet si parfumeri apo gjatë të cilave prodhohen gazra duhet të kryhet 6 herë në ditë.

Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.

Për çdo rast Administratori/Personi Fizik Tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror.

Subjekti duhet të afishojë detyrimin për vetëvlerësim të simptomave nga klientët dhe personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

Niveli i Riskut

Protokolli i masave higjensanitare COVID-19

Niveli i verdhë

Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitete, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti. Këtij protokollit i nënshtrohen edhe aktivitete që kanë 25-50 punonjës që punojnë në një ambient të përbashkët të mbyllur.

Personi i caktuar nga administratori/personi fizik kryen çdo ditë vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma ndërkohë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet në një ambient të veçuar të objektit derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.

Për çdo rast Administratori/Personi Fizik Tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësine Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror.

Personi i caktuar nga administratori/personi fizik mat temperaturën e punonjësve dhe të çdo personi tjetër klient në hyrje dhe dalje me termometër infrared dhe njofton menjëherë strukturat përkatëse për temperaturat me të larta se 37,5 gradë në rastet kur ka edhe simptoma të tjera të COVID-19.

Pavarësisht sa më sipër, personat e punësuar kryejnë çdo ditë vetëvlerësimin personal nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave personi duhet të njoftojë menjëherë 127 dhe Administratorin/Personin Fizik Tregtar. Për çdo rast Administratori/Personi Fizik Tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësine Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror. Nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe sipas rastit duhet të karantinohet në ambientin e paracaktuar.

Çdo punonjës është i detyruar të deklarojë ndaj Administratorit/Personit Fizik Tregtar nëse ka patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.

Çdo punonjës që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë Administratorin/Personin Fizik Tregtar. Punonjësi duhet të telefonojë 127 dhe mjekun e familjes.

Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar nga dispozitat ligjore.

Vajtja dhe ardhja në punë në këmbë kryhet duke ruajtur distancën 2 metra dhe jo duke krijuar grupime. Në rast të vajtje ardhjes në punë me shërbim transporti me autobuzë, punonjësit ulen në anësoret e dritareve të autobuzit dhe duke lënë një hapësirë rreshti bosh pas tyre. Në autobus apo automjet duhet mbajtur detyrimisht maska dhe dorezat dhe të shmanget prekja e sipërfaqeve. Autobusi dezinfektohet dhe ajroset çdo ditë. Për lëvizjen me automjet të zbatohen masat e publikuara nga Policia e Shtetit.

Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment doreza mbrojtëse, maska dhe higjenzues duarsh me mbi 60% alkol.

Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment sapun, letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve si dhe kosha plehrash të mbyllur të cilët duhen pastruar çdo ditë.

Personeli i punësuar dhe personat e tjerë klientë duhet të përdorin dorezat mbrojtëse sipas këshillave.

Personeli i punësuar dhe personat e tjerë klientë duhet të mbajnë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën. Kollitja dhe tështitja kryhen duke përdorur bryllin apo letër hundësh. Letra hidhet menjëherë në kosh.

Në hyrje dhe dalje subjekti duhet të ofrojë produktin higjenzues të duarve për personelin dhe këdo që hyn e del në ambientet e brendshme dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60% alkol.

Subjekti duhet të garantojë dhe respektojë në çdo moment distancën prej 2 metra midis personelit të punësuar dhe këtyre të fundit e klientëve. Subjekti riorganizon punën e tij me turne sipas një plani individual në mënyrë që të respektojë detyrimin e mësipërm.

Subjekti shërben aq klientë sa sportele arke apo shërbim klienti ka, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në rradhë.

Rekomandohet shmangia e parasë cash dhe ofrimi shërbimeve me pagesë me kartë krediti.

Subjekti vendos xham mbrojtës (plexiglass) midis punonjësit dhe klientit.

Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë. Subjektet të marrin masat përkatëse për ndërhyrje në sistemet e ventilimit ku të kalohet në modalitetin e ajrit natyral apo përmes shtimit të dritareve.

Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta përfshirë përshëndetjet.

Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmanget grumbullimi i personave në ambiente si guzhina, dhoma ngrënie apo ambiente të jashtme qoftë të subjektit apo publike.

Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes dhe të paktën 3 herë në ditë. Secili punonjës kryen dezinfektimin me produktet e higjensës të tavolinave, banaqeve, telefonave, kompjuterave, kufjeve dhe çdo hapësirë apo objekti ku ka patur kontakt prekje në fillim dhe përfundim të turnit. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Minsitria e Shëndetësisë.

Punonjësit gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve pa kryer dezinfektimin.

Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.

Subjekti duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar.

Subjekti duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të verdhë, sipas formatit të miratuar ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/administratori/ çdo person tjetër palë e tretë që hyn e del në ambientet e brendshme sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

Subjekti të afishojë të plotë protokollin e verdhë sipas tekstit të miratuar.

Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të subjektit si dhe në vende të dukshme në brendësi të subjektit.

Niveli i kuq

Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitetet, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti.

Këtij protokollit i nënshtrohen edhe aktivitetet që kanë mbi 50 punonjës që punojnë në një ambient të përbashkët të mbyllur.

Subjekti detyrimisht ka të punësuar personin përgjegjës për shëndetin në punë. Administratori i subjektit ka detyrimin e njoftimit pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të gjeneraliteteve dhe numrit të liçensës e personit përgjegjës për shëndetin në punë. Personi përgjegjës për shëndetin në punë dhe/ose administrator janë përgjegjës për implementimin e masave sipas këtij protokollit sipas detyrimeve të secilit prej tyre.

Personi përgjegjës për shëndetin në punë kryen çdo ditë vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar dhe të kujtudo që hyn e del në ambientet e punës, përfshirë administratorin, transportuesit, shpërndarësit, palë të treta që janë pjesë e zinxhirit furnizim, shpërndarje, shitje etj. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma ndërkohë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet në një ambient të veçuar të ndërmarrjes derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.

Për çdo rast personi përgjegjës për shëndetin në punë dhe administratori lajmërojnë menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror.

Personi përgjegjës për shëndetin në punë mat temperaturën e punonjësve/ administratorit apo çdo personi tjetër në hyrje dhe dalje me termometër infrared dhe mban librin përkatës me shënimet çdo ditë për temperaturat me të larta se 37,5 gradë apo të shfaqjes së simptomave të tjera. Personi përgjegjës për shëndetin në punë administron të dhënat mjekësore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale sensitive dhe ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

Pavarësisht sa më sipër, personat e punësuar kryejnë çdo ditë

vetëvlerësimin personal nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave personi duhet të njoftojë menjëherë 127 dhe personin përgjegjës për shëndetin në punë. Nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe sipas rastit duhet të karantinohet në ambientin e paracaktuar.

Çdo punonjës është i detyruar të deklarojë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës për shëndetin në punë nëse ka patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.

Çdo punonjës që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë administratorin dhe personin përgjegjës për shëndetin në punë. Punonjësi duhet të telefonojë 127 dhe mjekun e familjes.

Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar nga dispozitat ligjore.

Vajtja dhe ardhja në punë në këmbë kryhet duke ruajtur distancën 2 metra dhe jo duke krijuar grupime. Në rast të vajtje ardhjes në punë me shërbim transporti me autobuzë, punonjësit ulen në anësoret e dritareve të autobusit dhe duke lënë një hapësirë rreshti bosh pas tyre. Në autobus apo automjet duhet mbajtur detyrimisht maska dhe dorezat dhe të shamngjet prekja e sipërfaqeve. Autobusi dezinfektohet dhe ajroset çdo ditë. Për lëvizjen me automjet të zbatohen masat e publikuara nga Policia e Shtetit.

Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment doreza mbrojtëse, maska dhe higjenzues duarsh me mbi 60% alkool.

Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment sapun, letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve si dhe kosha plehrash të mbyllur të cilët duhen pastruar çdo ditë.

Personeli i punësuar/Administratori/personat e tjerë duhet të përdorin dorezat mbrojtëse sipas këshillave.

Personeli i punësuar/Administratori/ personat e tjerë duhet të mbajnë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.

Kollitja dhe tështitja kryhen duke përdorur bryllin apo letër hundësh.

Në hyrje dhe dalje subjekti duhet të ofrojë produktin higjenzues të duarve për personelin dhe këdo që hyn e del në ndërmarje dhe të

kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60% alkool.

Subjekti duhet të garantojë dhe respektojë në çdo moment distancën prej 2 metra midis personelit të punësuar. Subjekti riorganizon punën e tij me turne sipas një plani individual në mënyrë që të respektojë detyrimin e mësipërm.

Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë. Subjektet të marrin masat përkatëse për ndërhyrje në sistemet e ventilimit ku të kalohet në modalitetin e ajrit natyral apo përmes shtimit të dritareve, apo përmes shtimit të dritareve.

Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta si transportues, shpërndarës etj përfshirë përshëndetjet.

Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmanget grumbullimi i personave në ambiente si guzhina, dhoma ngrënie apo ambiente të jashtme qoftë të subjektit apo publike.

Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes dhe të paktën 5 herë në ditë. Secili punonjës kryen dezinfektimin me produktet e higjenes të tavolinave, banaqeve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka patur kontakt prekje në fillim dhe përfundim të turnit. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Minsitria e Shëndetësisë.

Punonjësit gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve.

Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.

Subjekti duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar.

Subjekti duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të kuq sipas formatit të miratuar ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/administratori/çdo person tjetër palë e tretë që hyn e del në ndërmarrje sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

Subjekti të afishojë të plotë protokollin e kuq sipas tekstit të miratuar.

Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të subjektit si dhe në vende të dukshme në brendësi të ndërmarrjes.

